



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1080 Prot.

Tiranë, më 12.04 2024

VENDIM QARKULLUES

Nr. 31 datë 12.042024

“PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI TË PROPOZIMIT TË RREGJISTRIT TË
PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE (NGA TË ARDHURAT DHE
NGA BUXHETI) PËR VITIN 2024, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS”

Mbështetur në 1/c të nenit 38 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, nenin 20 të Statutit të UST-së, në Vendimin e Rektoratit nr. 22 datë 29.03.2024, Senati Akademik

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e ndryshimit të Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2024 në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 1080 Prot.

Tiranë, më 12.04 2024

VENDIM QARKULLUES

Nr. 31 datë 12.04 2024

“PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI TË PROPOZIMIT TË RREGJISTRIT TË
PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE (NGA TË ARDHURAT DHE
NGA BUXHETI) PËR VITIN 2024, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS”

PROF.DR. ADRIATIK META

DR. ANDIS BOGDANI

PROF.ASOC. ARBEN KAÇURRI

PROF.DR.DHIMITRAQ SKËNDERI

PROF.DR. DHURATA BOZO

DR. ELTON SPAHIU

PROF.DR. FATOS GJATA

PROF.ASOC. FERDINAND MARA

PROF.ASOC. JUEL JARANI

PROF.ASOC. ROBERT ÇITOZI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORAT

Nr. 966/2 Prot.

Tiranë, më 29.03.2024

V E N D I M

Nr. 72 datë 29.03.2024

**“PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIM TË PROPOZIMIT TË RREGJISTRIT TË
PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE (NGA TË ARDHURAT
DHE BUXHETIN) PËR VITIN 2024, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 40, të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në statutin e UST neni 25, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin e ndryshimit të Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2024 në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UST-së.

Rektori

Prof. Dr. Agron Kasa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 038 Prot.

Tiranë, më 29.03 2024

RELACION

MBI NDRYSHIMIN E REGJISTRIT TË PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2024

REKTORATIT

SENATIT AKADEMIK

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

Të nderuar!

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë”, neni 38,40,49, në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 3, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Mbi Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, kërkohet ndryshimi i regjistrit të parashikimeve publike per zerat si me poshte vijon:

Zëri investime artikulli 231 me zërat si më poshtë vijon:

- 1. Investimi në Rikonstrukcion i Fushës së Futbollit dhe Pistës së Atletikës dhe Rrethimi në Universitetin e Sporteve të Tiranës.**

Objektivat për të cilat po investohet në këtë zë janë:

1. Formimi cilësor universitar dhe me standarte Europiane i studenteve në të gjithë ciklet e studimit
2. Përmirësimi i infrastrukturës sportive: Objektivi kryesor është përmirësimi i infrastrukturës sportive në universitet, duke ndërtuar një fushë futbollit dhe atletike dhe atletike të re dhe duke modernizuar atë ekzistuese për të përmirësuar përvojën e sportit për studentët dhe stafin e fakultetit.
3. Rritja e konkurrueshmërisë sportive - Investimi në një fushë futbollit dhe te atletikës të pajisur mirë ndihmon në rritjen e nivelit të performancës sportive të ekipeve të futbollit të universitetit, duke e bërë atë më konkurrues në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar.
4. Rritja e rekrutimit dhe mbajtja e studentëve: Një fushë futbollit dhe atë te atletikës e larmishme dhe tërheqëse është mjet i fuqishëm për të rekrutuar studentë të talentuar në programin sportiv të universitetit dhe për të ndihmuar në mbajtjen e tyre përmes një përvoje sportive të pasur.
5. Rritja e angazhimit studentor : Një objektivi tjetër është dhe rritja e angazhimit dhe pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete sportive nëpërmjet ofrimit të një infrastrukture tërheqëse dhe mundësive për të praktikuar dhe garuar në një mjedis të rregullt dhe të sigurt.
6. Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies - Investimi në një fushë futbollit dhe atletike të mirë-mirëmbajtur ndihmon edhe në promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së studentëve, duke ofruar një mundësi për aktivitet fizik dhe sport në një mjedis të stimulueshëm.
7. Krijimi i mundësive për turne dhe ngjarje sportive: Një fushë futbollit dhe atletike e pajisur mirë krijon mundësi për të organizuar turne, garat, dhe ngjarje sportive të tjera, duke promovuar bashkëveprimin dhe konkurrencën sportive në kampusin e Universitetit të Sporteve të Tiranës.
8. Ndikimi pozitiv në imazhin e universitetit: Një objektivi është edhe ndikimi pozitiv në imazhin dhe reputacionin e universitetit duke krijuar një kulturë sportive të fuqishme dhe duke e bërë atë një destinacion më të dëshirueshëm për studentët e ardhshëm

Perfitimet:

1. **Përparimi i infrastrukturës sportive:** Ndërtimi i një fushe futbollit dhe atletike do të sjellë një përmirësim të infrastrukturës sportive në Universitetin e Sporteve të Tiranës. Kjo do të ofrojë një ambient më të përshtatshëm për mësimdhënien, trajnimet dhe garat sportive për studentët dhe personelin e universitetit.
2. **Rritja e atraktivitetit për studentët:** Një fushe futbollit dhe atletike e re do të rrisë atraktivitetin e universitetit për studentët, veçanërisht ata që janë të interesuar për sportin. Kjo gjë të çojë në rritjen e numrit të aplikimeve dhe regjistrimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
3. **Mundësia për të organizuar garat dhe turnetë:** Me një fushe të re sportive, universiteti do të ketë mundësinë për të organizuar garat dhe turnetë sportive, duke i dhënë studentëve

dhe ekipit të universitetit mundësinë për të përballuar dhe garuar me ekipet e tjera, si dhe për të promovuar imazhin e universitetit në nivel lokal dhe kombëtar.

4. Përparimi i performancës sportive: Një fushe të re e futbollit dhe atletike do të ofrojë një mjedis më të mirë për trajnimet dhe përgatitjen e sportistëve. Kjo mund të çojë në përmirësimin e performancës sportive të studentëve të universitetit në garat dhe kompeticionet e ndryshme sportive.

Kostot:

1. Kostoja e ndërtimit: Ndërtimi i një fushe të re futbollit dhe atletike kërkon një investim financiar të konsiderueshëm për të blerë dhe instaluar infrastrukturën e nevojshme sportive.

2. Kostoja e mirëmbajtjes: Përveç kësaj, një herë që fusha është ndërtuar, ka një kosto të vazhdueshme të mirëmbajtjes së saj, duke përfshirë kujdesin për gjelbërimin, riparimet periodike dhe përditësimet e nevojshme.

3. Kostot administrative: Administrimi i një fushe sportive përfshin kosto të administratës dhe menaxhimit të programit sportiv, duke përfshirë pagesat për stafin e trajnuesve, sigurinë dhe organizimin e aktiviteteve.

Produktet-et që do të realizoj ky investim (dhe sipas rastit përfitimet të tjera që rezultojnë nga investimet)

a) Një fushë sportive në dispozicion të studentëve me standarte e përcaktuara nga UEFA për të gjitha moshat me të gjitha specifikat, dimensionet, elementet, rrjetet inxhinierike dhe mjediset ndihmese

b) Jetësimi dhe vënia në funksion të pistës së atletikës me katër korsi, kushtëzuar nga territori në dispozicion të ndërtimit të kësaj piste ku do të realizohen

- ❖ Kërcim së gjati
- ❖ Kërcim së larti
- ❖ Kërcim me shkop
- ❖ Hedhje gjyle
- ❖ Hedhje shtize
- ❖ Hedhje çekiçi

Piste vrapimi me 6 korsi

c) Organizimi i dy mjediseve veshje –ç’veshje me kapacitet prej 22 sportistësh secila, të paisura me tualete, duše me të gjitha kushtet bashkëkohore, mjedise dhe në funksion edhe të Pistës së Atletikës;

d) Tribunë e rindërtuar me rreth 570 vende me ndenjësë për spektatorë pjesa e poshtme e së cilës do të shërbejë dhe për vendosjen e mjediseve ndihmëse për gjyqtarët, mjekun dhe magazina për pajisjet sportive;

e) Zgjidhja apo përmisimi i rrjetit elektrik për të gjithë mjedisin.

f) Projektimi i rrethimit dhe sistemimit të mjediseve të jashtme jashtë fushës për të gjithë kompleksin

- g) Ndërtimi i plotë të gjitha nyjeve higjieno-sanitare dhe dusheve.
- h) Zgjidhja dhe shtrirja e sistemit të ngrohje-ftohjes për të gjithë ndërtesën nëpërmjet sistemit qëndror.
- i) Zgjidhja e sistemit të drenazhimit të gjithë fushës;
- j) Lidhja me rrjetin e Ujësjellësit.

“Rikonstruksioni i Fushës së Futbollit, Pistës së Atletikës dhe rrethimi” arrin në shumën 146.760.000 lekë e cila përfshin vlerën e ndërtimit, Oponencën dhe Lejen e Ndërtimit. Në bazë korrespondencës dhe takimeve me Ministrën e Arsimit nga Rektori i UST, si dhe procedurave nëpërmjet aplikimit në MASH nga Universiteti i Sporteve të Tiranës shkresë nr.349 datë 29.01.2024, ku me anë të shkresës së MAS nr. 746/1 prot datë 04.03.2024, ka miratuar financimin nga buxheti i shtetit në shumën 113 006 900 lekë ose 70 % të investimit. MFE me shkresë nr.3021/1 prot, datë 26.03.2024 “Transferim fondi për shpenzime kapitale” ka miratuar çeljen e këtyre fondeve.

Ky investim do të financohet nga buxheti i shtetit në dy vite: ku për vitin 2024 shuma e financimit është 36 005 900 lek dhe për vitin 2025 shuma e financimit është 77 000 000 lekë. Referuar shkresave më lart, ku MAS merr përsipër 70% të investimit, Universiteti i Sporteve duhet të bashkëfinancoj në masën 30% të vlerës së investimit pra shumën 48.431,100 lek e cila do të përballohen nga të ardhurat dytësore të UST-së.

2. Investim për paisjen me kamera sigurie të 4 laboratorëve në UST.

Referuar shkresave të DZHPDASHASH nr. 898 datë 26.03.2024, “Propozim mbi paisjen me kamera të 4 laboratorëve”, si dhe nr. 546/1 datë 15.02.2024 të FSHL, është kërkuar të vendosen kamera sigurie në Laboratorin e Lingustikës dhe Informatikës, për eliminim e problematikave dhe keqtrajtmeve, që janë vënë re kohët e fundit nga specialistët përgjegjës. Referuar shkresës nr. 898 datë 26.03.2024 shuma e kërkuar për këtë zë investimi është 120 000 lek me TVSH.

Bashkëlidhur tabelat për ndryshimim e RRRPP.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të miratimit nga ana juaj, për të vazhduar procedurat e mëtejshme.

ADMINISTRATOR

Haxhirete SULAJ



INSTITUCIONI QENDROR : MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISE

Autoriteti Kontraktor: Universiteti i Sporteve të Tiranës

Ndryshimi I Regjistrat te Parashikimeve të Prokurimeve Publike viti 2024.

Investimet nga te ardhurat dhe nga buxheti

Pakesime

Nr	Llogaria	Viti	I ri/ i modifikuar	Objekti i prokurimit	Kontratë, Marrëveshje kuadër	Tipi i kontratës (mall/punë /shërbim/ marrëveshje kuadër)	Fondi i llogaritur	Burimi i financimit (buxheti i shtetit, te ardhura, vetëfinancim, etj)	Vlera	Lloji i procedurës së prokurimit/Minikontratë/Amendament kontrate për nevojat e fillim viti	CPV Kod	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muaji)	Organi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
	2312103	2024	I ri	Rikonstruksione +Pajisje	Kontratë	Pune	37,393,330	Të ardhurat	44,028,000	Tender i hapur	45210000-2	Gjatë vitit 2024	UST

Nr	Llogaria	Viti	I ri/ i modifikuar	Objekti i prokurimit	Kontratë, Marrëveshje kuadër	Tipi i kontratës (mall/punë /shërbim/ marrëveshje kuadër)	Fondi i llogaritur	Burimi i financimit (buxheti i shtetit, te ardhura, vetëfinancim, etj)	Vlera	Lloji i procedurës së prokurimit/Minikontratë/Amendament kontrate për nevojat e fillim	CPV Kod	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muaji)	Organi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	2312103	2024	I ri	Rikonstruksione I fushes së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi ne UST	Kontratë	Pune	124,644,434	Të ardhurat+buxhet	69,760,000	Tender i hapur	45210000-2	Gjatë vitit 2024	UST
2	2312103	2024	I ri	Rikonstruksione I fushes së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi ne UST	Kontratë	Pune	37,393,330	Të ardhurat	44,028,000		45210000-2	Gjatë vitit 2024	UST
3	2312103	2024	I ri	Rikonstruksione I fushes së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi ne UST	Kontratë	Pune	87,251,104	Buxheti	25,732,000		45210000-2	Gjatë vitit 2024	UST
	2312103	2024	I ri	Tarifat per marjen e lejes se ndertimit		Sherbim		Buxheti	4,109,700			Gjatë vitit 2024	UST
	2312103	2024	I ri	Oponenca teknike	Kontratë	Mallra		Buxheti	6,164,200			Gjatë vitit 2024	UST
4	2314280	2024	I ri	Kamera sigurie	Kontratë	Sherbim	100,000.00	Të ardhurat	120,000	Prokurime me vlera te vogla	48812000-3 72212442-9	Gjatë vitit 2024	UST